



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 10 Maj 2012

Organizimi i ditëve informuese për Programin Infrastruktura Ekonomike dhe Sociale e Komunave i financuar nga BE-faza e VII (IPA 2011)

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me zyren e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Agjencionet për Zhvillim Rajonal, prej datës **02-04 Maj 2012** ka organizuar ditët informuese për Programin Infrastruktura Ekonomike dhe Sociale e Komunave i financuar nga BE-faza e VII (IPA 2011), i cili fond ka një vlerë prej 8.800.000,00€ (tetë milion euro), për të përkrahur projektet e infrastrukturës Ekonomike dhe Sociale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, dhe ku vlera maksimale e një projekti të paraqitura duhet të jetë vlerë e mesme dhe të mos kalojnë vlerën e mbi 1.000.000,00 € (një milion euro).

Ditët informuese janë organizuar në:

1. **Prishtinë**, Agjencioni për Zhvillim Rajonal-Qendër, datë 02/05/2012, ora 10:00;
2. **Gjilan**, Agjencioni për Zhvillim Rajonal-Lindje, datë 02/05/2012, ora 13:00;
3. **Mitrovicë**, Agjencioni për Zhvillimi Rajonal-Veri, datë 03/05/2012, ora 10:00;
4. **Pejë**, Agjencioni për Zhvillim Rajonal-Perëndim, datë 03/05/2012, ora 13:00;
5. **Prizren**, Agjencioni për Zhvillim Rajonal-Jug, datë 04/05/2012, ora 10:30.

dhe pjesëmarrës kanë qenë zyrtarët përgjegjës të komunave të Republikës së Kosovës të cilët merren me përgatitjen, aplikimin dhe monitorimin e projekteve të ndryshme të infrastrukturës komunale.

Gjatë prezentimit të Programit Infrastruktura Ekonomike dhe Sociale e Komunave i financuar nga BE-faza e VII (IPA 2011), me zyrtarët përgjegjës komunal një prezantim lidhur me procedurat, kriteret, rregullat, afatet kohore dhe kush ka të drejtë të aplikojë e ka bërë Drejtori i Departamentit për Zhvillim Regional dhe Integritet Evropiane në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal z. Besim Kamberaj si dhe për mjetet të cilat MAPL i ndan çdo vit buxhetor nga 2.5 mil si pjesë e financimit paralel me këto fond. Ndërsa prezentimin lidhur me atë se cilat projekte janë më primare dhe të cilat mund të financohen nga ky fond e ka bërë Task menaxheria e Infrastrukturës pranë zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë znj. Merita Govori.



Gjatë prezantimit të Programit në Prishtinë, datë 02/05/2012
Besim Kamberaj, Drejtori i DZHRIE/MAPL dhe
Merita Govori, Task menaxhere, zyra BE Kosovë



Gjatë prezantimit të Programit në Gjiilan, datë 02/05/2012



Disa nga zyrtarët komunal të ftuar në ditët informuese gjatë prezantimit të Programit në Gjilanë, datë 02/05/2012